

## STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

### ERS JEWELLERY sh.p.k

Sot ,më datë **19.12.2023** (dymijë e njëzetë e tre ) në Tiranë:

1. Emiljano Romeo Sakollari,shtetas Shqipëtar, lindur më 10.02.1992 në Tiranë,Shqipëri me pasaportë Shqipëtare BG0516368, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

### KAPITULLI I

#### EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

##### Neni 1

##### Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet **ERS JEWELLERY** shpk . (Këtu e më poshtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

##### Neni 2

##### Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë tek Rr.George W. Bush,nr.pasurie 6/3-N/18/3

##### Neni 3

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

##### Neni 4

##### Objekti

- 4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

**Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara**

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR**

**NENI 5**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (një qindë lekë ) i përbërë nga 1 kuote.

**Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 (nje) kuotë, me vlere nominale 100 lekë.**

z. Emiljano Sakollari zotëron 100 % të kapital të shoqërisë në vlerë 100 lekë (një qind lekë).

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblese së ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme.Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

**NENI 6**

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare.Kete te drejta ortaku duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e blesit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakut tjeter te shoqerise.

**NENI 7**

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bërë, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

**NENI 8**

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

**NENI 9**

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejtat qe janë krijuar para largimit te tij .

**NENI 10**

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarisë dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve ne proporcion me përqindjen e kapitalit te investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te zvogëlohet nen kufijtë e parashikuar ne ligj .

#### **NENI 11**

Shoqëria tregtare “**ERS JEWELLERY**” sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurive se vet tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare **ERS JEWELLERY sh.p.k** gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 12**

Shoqëria tregtare “**ERS JEWELLERY**” sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortakët themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortakët kane pasur para se ajo te krijohet.

### **KAPITULLI I III**

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 13**

##### **Kompetencat e ortakut**

**13.1** Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë se saj, duke përfshire edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare ne çdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësueseve ne ketë aktivitet.

**13.2** Kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit

**13.3** Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesen e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statute dhe ligji.

**13.4** Ortakët në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

**13.5** Ortakët rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

#### **NENI 14**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj z. Emiljano Sakollari

#### **NENI 15**

##### **Administrimi i shoqërisë**

**15.1** Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.

**15.2** Administratori përfaqëson shoqërinë në mardhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjygjësore.

**15.3.** Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit.Ortaku ka të drejtë të ngrej padi ndaj administratorit.

**15.4** Administratori emërohet dhe shkarkohen me vendim të ortakut, kanë të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

**15.5** Shoqëria administratohet të paktën (nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhe maksimale prej (5 vjetesh

**15.6.** Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbusimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë .

**15.7** Kur administrator i shoqërisë rezulton i sukseshem në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shperblimin që do ti jepet atij në fund të vitit financiar .

#### **NENI 16**

##### **Detyrat e Administratorit/ëve**

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Të mirë administroje pasurinë e shoqërisë
- Te lidhë marrveshje me të tretët Brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Të zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë
- Të shpërbleje dëmet që l vijnë shoqërisë si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve të tij.
- Të paguhet për punën e kryer në bazë të marrveshjes së bërë midis tij dhe ortakëve.

- Të marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithcka që ai e quan të dobishme për shoqërinë
- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe ti paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët
- Të bëhen propozimet përkatëse ortakut të vetem kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratoje aktet normative që përcaktojnë aportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin
- Të përcaktoje strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domozdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Ti propozojë ortakeve për krijimin e njësive ,strukturave të ndryshme si filial, dege e përfaqësi në qytetet të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim.Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqes propozimet për miratim para ortakeve .
- Të sigurojë zbatimin e përpikte të Vendimeve të Ortakëve.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortakut i vetëm i shoqërisë.

## **NENI 17 EKSPERTI KONTABEL**

**17.1** Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administrator

**17.2** Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë

**17.3** Ato përgjigjen për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

**17.4** Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës se parashikuar nga legjislacioni në fuqi .

**17.5** Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallen e katert. Po ashtu nuk mund të kryejë këto detyra përgjegjës të syrave, filialeve e agjensive.

## **KREU III MARDHENIET E PUNES NENI 18**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës.Për çeshtjet që kjo kontrate nuk l parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

## **NENI 19**

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **NENI 20**

### **Sekreti i punës**

Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë .Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

## **KAPITULLI I IV**

### **VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

## **NENI 21**

### **Viti financiar**

Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Përrjashtimisht Viti I parë financiar përrfshin kohen nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përrfundon më 31 Dhjetor të të nje viti.

Shoqëria **“ERS JEWELLERY”** shpk cakton si Ekspert Kontabël të saj znj. \_\_\_\_\_

## **NENI 22**

### **Inventari dhe llogarite vjetore.**

Shoqëria do te mbaje një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore

Në mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë ne ketë date dhe llogarite vjetore për vitin financiar .

## **NENI 23**

### **Raportet vjetore**

**23.1** Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.

**23.2** Raporti pasqyron gjëndjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

**23.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar(nëse është emëruar)miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

## **NENI 24.**

### **Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.**

**24.1** Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shume e barabartë me 5 % (pese perqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezerve të quajtur "rezerve e domosdoshme".

**24.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrijë 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

**24.3** Ortaket mund të vendosin edhe zbritje të veçantë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

## **NENI 25**

Të ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortaket duke i qëndruar në uljen 5 % që do të destinohet rezervë ligjore.

## **KAPITULLI V**

### **MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

## **NENI 26**

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

## **NENI 27**

**27.1** Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

**27.2** Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakeve.

**27.3** Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

## **NENI 28**

Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kesaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

## **NENI 29**

Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria ç' regjistrohet prej tij.

## **DISPOZITET KALIMTARE**

### **NENI 30**

#### **Dispozitat e fundit**

**30.1** Për te gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

**30.2** Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”

**30.3** Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të çënojnë vlefshmërinë e tij.

### **NENI 31**

#### **Gjykata kompetente.**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarveshjeve dhe intepretim e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **NENI 32**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshem për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortaket.

## **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**ERS JEWELLERY sh.p.k**